



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.90/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore, Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Suharekë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Suharekë, për shkak të vendosjes së posterit në objekte dhe në hapësirë publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Suharekë, ZL.Anr.90/2017, të datës 28.09.2017, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Suharekë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1.200,00 (njëmijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 28.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 28.09.2017, në rrugën “Skënderbeu” në Suharekë, në një trafo stacion elektrik janë vendosur postera të kandidatit për Kuvendin Komunale në Suharekë, Kushtrim Kuçi nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK).

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 pika b), të LPZ-së, të dispozitës së nenit 4.1 pikës b të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur katër(4) fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë të datës 29.09.2017, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka kërkuar të hudhet poshtë ankesa sepse duket të jetë ankesë e përsëritur me foto të bëra para evitimit të shkeljes së supozuar. Dallimi qëndron në këto foto vetëm se duket që fotot e reja janë bërë ditën, ndërsa ato të mëparshmet duket qartë se janë bërë natën dhe aty në ndërkohë janë vendosur foto edhe të një kandidati tjetër. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur dy fotografi nga vendi ku janë larguar pllakatat.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoj se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posteret e kandidatit për Anëtar të Kuvendit Komunal në Suharekë, nga radhët e subjektit politik LDK, janë vendosur në trafo stacion elektrik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit për Anëtar të Kuvendit Komunal në Suharekë, nga subjekti politik i LDK-së, janë vendosur në objektin publik përkatësisht në trafo stacion elektrik. Pretendimi i subjektit politik LDK-së se ankesa është e përsëritur nuk qëndron, pasi që ankesa me nr.54/2017, ka të bëjë me rrugën “Endrit Kavaja” në Suharekë, ndërsa kjo shkelje është bërë në rrugën “Skënderbeu” në Suharekë, po ashtu trafo stacioni elektrik nuk është i ngjashëm.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti posterat e kandidatit të këtij subjekti politik janë vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar janë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr. 90/2017 më datën 03.10.2017.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4 të LZP-së.